




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 04/L-44, në takimin e mbajtur me datën 6 shkurt 2024, mori këtë:

V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Nr.Ref.2310/840/KPM i datës 3 tetor 2023, në lidhje me largimin e kanaleve Arena Sport nga platformat kabllore;
2. Obligohen operatorët e shpërndarjes që të ndërmarrin masa rigoroze në mënyrë që të sigurohen që përmbajtjet e transmetuara nga kanalet e huaja të jenë në pajtim të plotë me Rregulloren KPM-2020/01;
3. Çdo ritransmetim i kanaleve përmbajtja e të cilave cenon interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme të Republike së Kosovës, do të rezultojë me ndërprerjen e përhershme të tyre në Republikën e Kosovës.

A R S Y E T I M

KPM, me datën 3 tetor 2023, duke u bazuar në nenin 19 të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale ka urdhëruar operatorët kabllor t'i largojnë nga ritransmetimi kanalet Arena Sport, me qëllim të parandalimit të përmbajtjeve programore të cilat cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Vendimi i KPM-së për largimin e kanaleve Arena Sport është bazuar në rrethanat ekzistuese dhe kontekstin kohor dhe nevojën imediate për reagim dhe si i tillë ka qenë valid deri në një vendim tjetër të KPM-së.

Operatori Artmotion, me datën 10 tetor 2023 dhe 5 shkurt 2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi, me arsyetimin se rishqyrtimi i këtij vendimi do të ishte në dobi të përdoruesve të cilët janë përjashtuar nga qasja në evente sportive dhe se kjo do të ndihmonte edhe respektimin e obligimeve kontraktuale me përdoruesit.


Në lidhje me këtë çështje edhe operatori MTS me datën 17 tetor 2023 dhe 6 shkurt 2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi, me arsyetimin se rishqyrtimi i këtij vendimi do të ishte në dobi të përdoruesve të cilët janë përjashtuar nga qasja në evente sportive.

Operatori Artmotion dhe MTS gjithashtu kanë dorëzuar një konfirmim përmes të cilit Arena Sport zotohet se përmbajtje të tilla më nuk do të përsëriten dhe se Arena Sport deri më tani nuk ka pasur asnjë problem në përmbajtjet e transmetuara.

Gjithashtu, në lidhje më këtë çështje, vet Arena Sport është zotuar së do të ndërmarrë masa konkrete për të parandaluar transmetimin e çfarëdo mesazhi politik gjatë transmetimit të ngjarjeve sportive dhe spoteve reklamuese në të ardhmen, duke formuar një trup të veçantë e cila do t'i rishikojë paraprakisht të gjitha përmbajtjet programore. Arena Sport gjithashtu është zotuar se do t'i respektojë në mënyrë rigorozë rregullat e përcaktuara nga KPM-ja, për t'u siguruar që përmbajtja e transmetuar nga Arena Sport nuk cenon asnjë rregullore të KPM-së dhe se përmbajtjet e transmetuara me herët nuk kanë qenë të qëllimshme.

Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktin se kanë pushuar rrethanat të cilat kanë determinuar marrjen e këtij vendimi, garancitë e operatorëve dhe vet kanaleve të Arena Sport se përmbajtje të tilla nuk do të përsërisin si dhe interesin e qytetarëve/përdoruesve për të pasur qasje në ngjarjet sportive, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



07.02.2024

Data